

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK

NJOFTIM

Ju lutemi, gjeni më poshtë njoftimin e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës, e cila do të zhvillohet ditën e hënë, datë 26 Shkurt 2024, ora 16:00, në sallën e Këshillit Bashkiak.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në zbatim të nenit 53 të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ju përcjell për shqyrtim dhe diskutim, pikat e rendit të ditës, si më poshtë:

1. Projektvendim “Për miratimin e familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 përqind, nga fondi i kushtëzuar dhe nga buxheti i Bashkisë Tiranë, për periudhën 1- 31 janar 2024”.
2. Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin nr. 130, datë 22.12.2023, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e listave të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, që përfitojnë bursa dhe pagesa, për vitin shkollor 2023-2024”.
3. Projektvendim “Për emërtimin e disa rrugëve në territorin e Bashkisë Tiranë”.
4. Projektvendim “Për miratimin e kontratës së sipërmarrjes midis Bashkisë Tiranë dhe subjektit tregtar “Mentor Petrela”, Person fizik”.
5. Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin nr. 120, datë 15.11.2023, të Këshillit Bashkiak “ Për zgjerimin e territorit për mbulimin e shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane nga shoqëria Eco Tirana sh.a në Bashkinë Tiranë”.
6. Projektvendim “Për Prishjen e detyruar të ndërtesës private, pallati nr. 10, rruga “Besim Daja”, njësia administrative nr. 8 , si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019”.
7. Projektvendim “Për Prishjen e detyruar të ndërtesës private, pallati nr. 39/43, rruga “Ferit Xhajko”, njësia administrative nr. 8, si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019”.
8. Projektvendim “Për Prishjen e detyruar të ndërtesës private, pallati nr. 5, rruga “Ferit Xhajko”, njësia administrative nr. 8 , si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019”.
9. Projektvendim “Për dhënien e pëlqimit mbi shpërndarjen e aktiveve të mbetura, sipas të drejtave që ortakët kanë në ndarjen e fitimeve në shoqërinë “Superbeton” sh.p.k.

Ju faleminderit,

Romina Kuko

Kryetare e Këshillit Bashkiak

MBLEDHJET E KOMISIONEVE

Komisioni i Edukimit dhe Infrastrukturës Arsimore, do të shqyrtojë pikën 2 dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e premte, datë 23 shkurt, ora 10:00.

Komisioni i Kulturës, Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore, do të shqyrtojë pikën 3 dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e premte, datë 23 shkurt, ora 11:00.

Komisioni për Sigurinë dhe Emergjencat Civile, do të shqyrtojë pikat 6,7,8 dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e premte, datë 23 shkurt, ora 12:00.

Komisioni i Financave dhe Buxhetit, do të shqyrtojë pikat 1,2,5,9 dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e premte, datë 23 shkurt, ora 13:30.

Komisioni i Çështjeve Ligjore dhe Drejtësisë Sociale, do të shqyrtojë pikat 2,4,5,6,7,8,9 dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e premte, datë 23 shkurt, ora 15:00.